



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ Nr/ _____ / 2018

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT: **DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) KOMUNA HANI I ELEZIT SHPALL;**

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLËN E MESME TË LARTË “DARDANIA” PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019

| Nr. | Emri i shkollës | Numri i paraleleve | Nr.i nxënësve | Profili (drejtimi) | Gjithsejtë |
|-----|----------------------------------|--------------------|---------------|-----------------------------|------------|
| 1 | SHML “Dardania” Hani i Elezit | 2 | 56 | Gjimnazi- shoqëror-gjuhësor | 56 |
| | | 2 | 56 | Shkencat Natyrore | 56 |
| | Gjithsej | | | | 112 |

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2017/18, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në shkollën e mesme të lartë duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron),
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9), dhe
- Certifikatën e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2018/2019, bëhet më datën **18, 19, 20 dhe 21 Qershor 2018** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet, duke filluar nga ora **8.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën: **26.06.2018**

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet më **:27.06.2018** nga ora 12:00 – 14:00.

Shpallja e konkursit plotësues për muajin vgsusht për vendet e lira më: **20.08.2018**

Dorëzimi i dokumenteve për konkurs plotësues bëhet më datat: **20,21 dhe 22 gusht 2018**

Shpallja e rezultateve për konkurs plotësues bëhet më: **24.08.2018**, kurse tërheqja e dokumenteve të kandidatëve të cilit nuk janë pranuar bëhet më: **27.08.2018** nga ora 12:00 – 14:00

4. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

5. Afati i ankesave

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve nga koha e shpalljes së rezultateve, t'i paraqes ankesë fillimisht drejtorisë së shkollës, e pastaj nëse sërish është i pakënaqur me përgjigjen e shkollës, mund t'i drejtohet Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa. DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.

Data: 18.06.2018
Hani i Elezit

Drejtori i DAKRS
Menduh Vlasi
